



Për Median

29 Shtator, 2011

Njoftim për shtyp

Koncert për rritjen e ndërgjegjësimit kundër dhunës së fëmijëve në shkollë dhe familje

Sot me datë 29 Shtator, 2011, do të realizohet një koncert, në sheshin kryesor të Beratit, ora 17:30-18:30, për rritjen e ndërgjegjësimit kundër dhunës së fëmijëve në shkollë dhe familje .

I organizuar nga Bashkia Berat, Drejtoria Arsimore Rajonale, Save the Children, Raiffeisen , Pro credit dhe Societe' Generale si edhe Kompania Qendra Shqiptare, koncerti synon të theksojë të drejtën e fëmijëve për t'u rritur dhe për të mësuar në një ambient të sigurt pa frikë dhe dhunë .

Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri është e përhapur në forma të ndryshme. Raportet tregojnë shifra të larta të dhunës fizike dhe psikologjike kundër fëmijëve në familje, shkollë dhe institucione sociale. Në shkollë, afërsisht 1 në tre fëmijë raporton se shpesh është tërhequr/ shtyrë me forcë dhe shpesh është gjuajtur me një objekt. 1/3 raportojnë se kanë dëgjuar mësuesit që tu bërtasin shpesh në shkollë¹. 74.8% e prindërve dhe 68.5% e mësuesve besojnë se fëmijët mësojnë ti respektojnë prindërit dhe mësuesit nga frika se mos rrihen prej tyre² - Edhe pse shkolla duhet të luajë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi, shpesh mësuesit përdorin sjellje dhune si mënyrë për ti nxitur fëmijët që të rritin performancën dhe të ushtrojnë autoritetin e tyre për të fituar respekt me disiplinë. Panvarësisht udhëzimeve nga MASH-i për të parandaluar dhunën, nuk është ndërtuar asnjë sistem specifik në nivel shkolle për të regjistruar dhe trajtuar incidentet e dhunës . Në shumicën e rasteve nxënësit shfaqin frikë nga raportimi i incidenteve të dhunës së ushtruar nga mësuesit si rezultat i kundërvëprimit ndëshkues të mundshëm.

Koncerti do të përfshijë: Fjalime përshendetëse nga Kryetari I Bashkisë, Kryetari I Drejtorisë Arsimore Rajonale Berat dhe Drejtoreshës së Save the Children ; Recital i këngëtares Rosela Gjylbegu, i shoqëruar me mesazhe kundër dhunës ndaj fëmijëve, poezi të shkruara nga fëmijët të cilat trajtojnë dhunën kundër fëmijëve; Muzikë tradicionale dhe moderne nga artistë vendas; trupa e baletit të të rinjve. Banderola, bluza, postera dhe fletëpalosje me mesazhe kundër dhunës ndaj fëmijëve, do t'i japin një vlere më shumë koncertit dhe përpjekjeve për të rritur ndërgjegjësimin publik kundër dhunës ndaj fëmijëve.

Anëtarët e komunitetit dhe gazetarët, lokal dhe kombëtar janë të ftuar që ta ndjekin koncertin dhe të na bashkohen në promovimin e të drejtës së fëmijëve për t'u mbrojtur dhe për t'u rritur në një ambient të sigurt dhe të ngrohtë larg frikës dhe dhunës.

Koncerti është një nga aktivitetet ndërgjegjësuese të projektit të zbatuar nga organizata Save the Children në partneritet me autoritetet lokale të qytetit të Beratit. Projekti synon të luftojë fenomenin e

¹ Dhuna kunder raportit te femijeve (UNICEF 2006)

² "Dhuna kunder femijeve ne shkolle", (Save the Children 2007).

përdorimit të dhunës fizike dhe psikologjike të fëmijëve në shkollë dhe në shtëpi, me qëllimin final të uljes së ndjeshme të përdorimit të të gjitha formave të dhunës kundër fëmijëve të moshës 3-15 vjeç.

Ky projekt, financuar nga organizata Save the Children Itali, përfshin drejtpërdrejtë 1094 fëmije, mësuesit dhe prindërit e tyre, në dy shkolla, një kopsht si edhe komunitetet përkatëse. Këto komunitete, identifikuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale si objektiv I projektit, njihen nga autoritet lokale si komunitetet më të varfra dhe më të cënueshme në Bashkinë e Beratit.

Strategjitë kryesore të projektit janë për përfshirjen aktive të fëmijëve, familjeve dhe gjithë anëtareve të komunitetit në përpjekje për uljen e përdorimit të dhunës në shkollë dhe në shtëpi. Për të rritur kapacitetin profesional të mësuesve, psikologëve, të stafit të Bashkisë dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale si edhe për të rritur burimet dhe përpjekjet nëpërmjet krijimit të një Task Force, që përfshin institucionet publike lokale dhe kompanitë private. Kjo do të kontribuojë në mobilizimin e strukturave lokale ekzistuese dhe të institucioneve për promovimin e aktiviteteve të qëndrueshme kundër përdorimit të dhunës ndaj fëmijëve në komunitetet e tyre.

Për informacion të mëtejshëm ju lutem kontaktoni:

Eda Hoxha,

Koordinatorë Informacioni

Save the Children

Tel: +355 4 2261840 / +355 4 2261929 / +355 4 2266227

Faks: +355 4 2263 428

Celular:+355 68 20 29190

Adresa: Rr."Komuna e Parisit", L 8,

Pallatet 1 maji, Vila "Lami", Tirane

P.O. Box 8185

E-mail: edahoxha@scalbania.org

Web Page <http://www.scalbania.org/>